

Pyetje për fazën e dytë – Aplikimi për projekt propozimet

Në "Udhëzuesin për grantet tematike dhe rajonale", në pikën 5.4.c kërkohej edhe CV e ekspertëve kyç që do angazhohen gjatë gjithë kohës së projektit. Në lidhje me këtë, bëhet fjalë për stafin e projektit ku përfshihen koordinatori, asistenti i projektit, financieri dhe pozicione të tjera të ngjashme apo duhen edhe CV të konsulentëve që do të përfshihen në projekt për një periudhë të caktuar?

Përveç CV-ve të stafit kryesor të projektit (koordinatori, asistenti i projektit, financieri dhe pozicione të tjera të ngjashme), ju këshillojmë që të përfshini edhe marrëveshjet e bashkëpunimit dhe CV-të e të gjithë ekspertëve kyç të parashikuar për t'u angazhuar në projekt, edhe nëse këta do të jenë të përfshirë vetëm për periudha të caktuara. Ky informacion do të ndihmojë në vlerësimin më të plotë të zbatueshmërisë së projektit tuaj.

Kur thoni se lista e dokumentave duhet të dërgohen si nga aplikanti kryesor edhe partnerët e keni fjalën se ato mbledhen nga aplikanti kryesor dhe do të dërgohen bashkë me projekt propozimin e plotë apo secili nga partnerët duhet të dërgojë më vete dokumentat e tij?

Aplikanti kryesor është përgjegjës për mbledhjen dhe përfshirjen e të gjitha dokumenteve në një paketë të vetme. Paketat përkatëse aplikanti kryesor duhet t'i ngarkoj në hapsirën respektive të aplikimit në faqen GreenAL dhe t'i dërgojë bashkë me projekt-propozimin e plotë. Pra, aplikanti kryesor duhet të:

- **Mbledhë dokumentet** e tij dhe ato të partnerëve.
- **Sigurohet që të gjitha dokumentet e kërkuara** janë përfshirë sipas udhëzimeve të dhëna (p.sh., vendimet e regjistrimit në gjykatë të jenë në një paketë, Statutet dhe Aktet e themelimit së bashku me NIPT-et në një paketë, CV-të e ekspertëve të përfshirë në projekt në një paketë, etj.).
- **Ngarkojë dhe të dërgojë dokumentet e kërkuara si dosje**, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, tek hapsira 'Faza e Dytë e Aplikimit' në faqen GreenAL.

Në udhëzuesin tuaj flisni për monitorimin alternativ dhe sugjeroni që të konsultohemi me ju kur është nevoja për të kryer matje. Përpara se të përgadisim buxhetin, çfarë keni parasysh me ndihmën që na ofroni? Janë vetëm aparaturat, ekspertiza apo edhe kryerje e analizave? Nëse nuk kryeni ju analiza, keni të përzgjedhur ju ndonjë laborator që duhet ti drejtohem edhe ne apo këtë laborator duhet ta identifikojmë vetë?

GreenAL ofron mbështetje për monitorimin alternativ përmes huazimit pa pagesë të pajisjeve që disponon, të cilat mund të përdoren gjatë periudhës së zbatimit të projekteve për matje të parametrave specifike të ajrit, zhurmave, ujit dhe tokës. Pajisjet dhe llojet e parametrave që ato masin janë të përshkruara në dokumentin "[Metodologjia e Monitorimit Alternativ](#)" të disponueshëm në faqen tonë të internetit

(<https://greenal.al/sq/monitorime/>). GreenAL nuk ka marrëveshje me laboratorë të caktuar. Prandaj, aplikantët duhet të identifikojnë vetë laboratorët e përshtatshëm për analizat që planifikojnë të realizojnë, përtej listës së analizave të cilat mund të kryhen nga paisjet që GreenAL mund tju huazojë.

Përveç huazimit të pajisjeve, ne ofrojmë udhëzime për përdorimin e tyre dhe mund të ofrojmë asistencë për interpretimin e të dhënave të mbledhura.

Në hartimin e buxhetit dhe më pas në zbatimin e tij, buxheti do të jetë i ndarë mes organizatës drejtuese dhe partnerëve apo organizata drejtuese mban përgjegjësinë e menaxhimit të buxhetit?

Buxheti i projektit ndahet mes organizatës drejtuese dhe partnerëve, duke reflektuar aktivitetet dhe përgjegjësitë e secilit partner në projekt. Megjithatë, organizata drejtuese, si partneri kryesor, mban përgjegjësinë për monitorimin e zbatimit të buxhetit dhe përgatitjen e raporteve financiare dhe narrative.

Një person që është anëtar i skuadrës së projektit a mund të paguhet për më shumë se një punë apo detyrë?

Nëse një person është anëtar i skuadrës së projektit dhe është i angazhuar 100% në projekt, atëherë ai nuk mund të paguhet për më shumë se një punë apo detyrë të lidhur me projektin. Kjo do të thotë se angazhimi dhe pagesa e tij do të mbulojë vetëm detyrat dhe përgjegjësitë që lidhen drejtpërdrejt me projektin në fjalë.

Për Aplikantët pa buxhet, pika 2.2.3 e thirrjes, duhet të dorëzojmë dokumentacionin e kërkuar në pikën 5.4 gërma c të saj? Gjithashtu, për këta aplikantë pa buxhet, do të duhet të bashkëlidhim marrëveshje bashkëpunimi në të cilën të evidentohet roli i secilit prej partnerëve (pika 5.4 gërma c, numri 6.)

Në lidhje me aplikantët pa buxhet, dëshirojmë të sqarojmë se është e nevojshme të përgatitet dhe të bashkëlidhet një marrëveshje bashkëpunimi. Ky dokument duhet të pasqyrojë qartë arsyen pse aplikanti është zgjedhur, rolin specifik që ai do të ketë në projekt dhe vlerën e shtuar që ai sjell. Marrëveshja duhet të jetë e hartuar në përputhje me pikën 5.4, gërma c, numri 6 të thirrjes.

Sa i përket dokumenteve të tjera të kërkuara në pikën 5.4, gërma), ju konfirmojmë se ato që përmenden nga numri 1 deri në numrin 5 nuk janë të nevojshme për aplikantët pa buxhet.

Nëse në projekt propozim për Lot 1 - grantet tematike, do të planifikohet ngritja e një fidanishteje pyjore dhe mbjellja e fidanëve të prodhuar nga ajo fidanishte, shpenzimet e kësaj natyre a do të konsiderohen investim në projekt?

Shpenzimet për ngritjen e një fidanishteje pyjore dhe mbjelljen e fidanëve të prodhuar nga ajo fidanishte do të konsiderohen si **investime** në kuadër të projektit. Sipas rregullave të Lot 1, fondet e përfituara nga ky grant **nuk mund të përdoren për të mbuluar investime**. E vetmja mënyrë për të mundësuar ndërtimin e fidanishtes është nëpërmjet **bashkëfinancimit** nga ana juaj.

Kemi formuar një koalicion mes liderit, dhe dy bashkëaplikantëve. Logjika e projektit tonë kërkoj që të krijohet një skemë e tillë: Lider (mjedis/kurrikul) + K1 (mjedis) + K2 (inovacion). K2 nuk e ka në objektivat e organizatës mbrojtjen e mjedisit, por ka aplikuar projekte mjedisore inovatore. A përben kjo problem? Në rast se po, a mund ta zëvendësojmë K2 me një bashkëaplikant që ka në mënyrë eksplicite në statut mbrojtjen e mjedisit?

Nuk përbën domosdoshmërisht problem nëse objekti i organizatës në statut nuk përfshin në mënyrë eksplicite mbrojtjen e mjedisit, për aq kohë sa eksperiencia e saj në projekte mjedisore mund të provohet me dokumente përkatëse (si CV e organizatës, referencat, etj.). Megjithatë, nëse nga vlerësimi juaj strategjik për projektin dhe sigurinë që dëshironi të krijoni përpara panelit të vlerësuesve e mendoni të arsyeshme ndryshimin e bashkëaplikantit kini parasysh se: *Aplikanti kryesor mund të shtojë, zëvendësojë një ose më shumë nga bashkë aplikantët apo aplikuesit pa buxhet vetëm nëse ka një arsyetim të qënësishëm për të kryer këtë ndryshim* (Udhëzues Për Grantet Tematike dhe Rajonale, Pika 5.1)

Kemi përfshirë dhe një institucion si bashkëaplikant pa buxhet. Çfarë dokumenti kërkohet nga ky institucion? A mjafton një letër suporti?

Për aplikantët pa buxhet rekomandohet përgatitja e një Marrëveshjeje Bashkëpunimi. Kjo marrëveshje formalizon marrëdhënien dhe e bën më të qartë për panelin e vlerësuesve kontributin dhe angazhimin e këtij partneri dhe duhet të përfshijë arsyen pse është zgjedhur si bashkëaplikant, rolin specifik që do të ketë në zbatimin e projektit si dhe vlerën e shtuar që ky partner sjell në projekt.

Në formulimin e buxhetit çfarë duhet plotësuar tek kolona 'shkalla e njësisë' dhe si rrjedhim tek kostot? Gjithashtu, nëse një person përfshihet në përqindje të caktuar në projekt, pra jo 100%, ku duhet theksuar kjo gjë, dhe në vijim duhet të shënojmë vetëm pagesën nga projekti apo edhe pagesa të tjera?

Nëse një person nuk është i përfshirë me kohë të plotë në projekt, kjo duhet pasqyruar në kolonën **# e njësisë**, ku mund të specifikoni numrin e muajve ose përqindjen e përfshirjes gjatë zbatimit të projektit.

- Në kolonën **Shkalla e njësisë**, vendosni **koston mujore** të këtij zëri të buxhetit.
- Për të llogaritur koston totale, shumëzoni numrin e njësisë (# e njësisë) me shkallën e njësisë (kosto mujore).
- Për sa i përket pagesës, duhet të pasqyroni vetëm **pagesën që mbulohe nga projekti**, dhe jo pagesat e tjera që personi mund të marrë nga burime të tjera.

Referohuni fotos së mëposhtme, për një shembull:

Emri i aplikantit: _____

Titulli i veprimit: _____

BUXHETI 1	SHPENZIME				SHPJEGIME
	Njësia	# e njësive	Shkalla e njësise	Kostot	
Kostot					Jepni një sqarim narrativ të secilit zë të buxhetit duke demonstruar llogaritjen dhe mënyrën se si ato lidhen me veprimin (p.sh. përmes referimeve në aktivitete).
(shto nën-tituj nëse kërkohet)			(në EURO)	(në EURO)	
1. Pagat e personelit të përfshirë					
<i>Paga (pagat bruto) 2</i>					
Staff Administrativ (20%)	në muaj	2.4	392.47	941.928	

Si duhet pasqyruar në buxhet ndarja e tij me organizatat partnere, si ndarje bruto apo zë për zë, pa specifikuar se kujt organizate i takon kjo?

Buxheti duhet të pasqyrohet **zë për zë**, pa specifikuar detyrimisht se kujt organizate i takon çdo zë.

- Nëse dëshironi, mund të përfshini ndarjen mes organizatave partnere dhe të tregoni se kujt i takon çdo zë.
- Në rast se nuk specifikohet, mbetet përgjegjësi e partnerëve të përcaktojnë përdorimin e fondeve në përputhje me zërat e miratuar të buxhetit.